

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sikagard®-545 WE Elastofill

VESHJE ELASTIKE PËR RREGULLIMIN DHE MBUSHJEN E SIPËRFAQEVE PREJ BETONI DHE LLAÇI



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Veshje elastike për rregullimin dhe mbushjen e sipërfaqeve prej betoni dhe llaçi, me 1 përbërës dhe me bazë rrëshirash akrilike. Është krijuar si një shtresë e ndërmjetme, që përmbahet me Sikagard®-545 WE Elastofill, duke formuar një sistem me kapacitet për mbylljen e plasaritjeve, me përdorimin e prajmerit të përshtatshëm.

PËRDORIMET

- Sikagard®-545 WE Elastofill është krijuar si një shtresë e ndërmjetme me kapacitet mbylljeje të plasaritjeve në kombinim me Sikagard®-550 Elastocolor ES
- Sikagard®-545 WE Elastofill si shtresë mbushëse mbyll porët dhe kavitetet, etj.

- Sikagard®-545 WE Elastofill si një shtresë izoluese me ngjyrë mbron dhe dekoron.
- Sistemi për ngushtimin e plasaritjeve Sikagard®-545 WE Elastofill përdoret për mbrojtjen dhe dekorimin e strukturave prej betoni (beton normal ose me peshë të lehtë), sidomos sipërfaqet e jashtme prej betoni me rrezik të lartë plasaritjeje.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i lehtë
- Me bazë uji
- Produkt me 1 përbërës, gati për përdorim
- Përshkueshmëri e mirë e avujve të ujit
- Rezistencë e lartë kundër karbonimit
- Kompatibël me shumë lloje bojërash të vjetra
- Mbyllje plasaritjesh edhe në temperatura të ulëta (-20°C).
- Rezistencë ndaj cikleve ngrirje-shkrirje dhe kripës për shkrirje akulli
- Sipërfaqe përfundimtare me teksturë

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshira akrilike të shpërndara në ujë.
Ambalazhi	Kovë plastike ovale 18 kg.
Paraqitja / Ngjyra	Pastë gri e lehtë
Jetëgjatësia	18 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Në konteinerin origjinal, të mbyllur mirë dhe të pashkatërruar. Të mbrohet nga ngrica dhe rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.
Dendësia	~ 1,20 kg/l
Përmbajtja e substancave të ngurta	62% për vëllim

TË DHËNA TEKNIKE

Aftësia e ngushtimit të plasaritjeve	2.4 mm (rezultate të përftuara nga sistemi 20°C)
--------------------------------------	--

Rezistenca ndaj difuzionit të avujve të ujit	Trashësia e cipës së thatë	d= 350 µm
	Trashësia ekuivalente e ajrit	Sd CO ₂ > 200 m
	Koeficienti i rezistencës ndaj CO ₂	µCO ₂ > 200.000
Absorbueshmëria kapilare	< 0.03 kg/m ² x h ^{0.5} (rezultatet e sistemit)	
Rezistenca ndaj karbonimit	Trashësia e cipës së thatë	d= 350 µm
	Trashësia ekuivalente e ajrit	Sd CO ₂ < 4 m
	Koeficienti i rezistencës ndaj CO ₂	µCO ₂ < 2.500

INFORMACIONE MBI SISTEMIN

Struktura e sistemit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Prajmer: 1 shtresë Sikaguard®-552 W Aquaprimer: ~ 0,1 kg/m². ▪ Rregullimi: 1-2 shtresa Sikagard®-545 WE Elastofill: ~ 0,8-1 kg/m² dhe shtresëzoni. ▪ Veshja: 2-3 shtresa Sikagard®-550 Elastocolor ES: ~ 0,250-0,350 kg/m² dhe shtresëzoni.
----------------------	--

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	Gati për përdorim, por preferohet të përzihet përpara përdorimit me një mikser elektrik.
Konsumimi	Duhet të aplikohen 1 ose 2 veshje midis 0,8 dhe 1,0 kg/m ² .
Trashësia e shtresës	0.5 mm për veshje
Temperatura e mjedisit	Min. +8°C / Max. +35°C
Pika e vesës	Temperatura duhet të jetë të paktën 3°C mbi pikën e vesës.
Temperatura e nënshtresës	Min. +8°C / Max. +35°C
Lagështia e përmbajtur e nënshtresës	< 80 %

Koha e pritjes / mbiveshja

Veshja paraprake	Koha min. e pritjes	Shtresa vijuese
Sikaguard®-552 W Aquaprimer ES	10°C: 24 orë 20°C: 12 orë 30°C: 6 orë	Sikagard®-545 WE Elastofill
Sikagard®-545 WE Elastofill	10°C: 24 orë 20°C: 12 orë 30°C: 6 orë	Sikagard®-545 WE Elastofill
Sikagard®-545 WE Elastofill	10°C: 20 orë 20°C: 10 orë 30°C: 5 orë	Sikagard®-550 Elastocolor ES
Sikagard®-550 Elastocolor ES	10°C: 12 orë 20°C: 8 orë 30°C: 6 orë	Sikagard®-550 Elastocolor ES

Kohët e pritjes duhet të dyfishohen kur lyeni sërish bojërat e vjetra.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme, kompakte, e pastër dhe pa pluhur, pislleqe, graut, grimca të lira, mbetje disarmentësh, etj. Lagështia e nënshtresës në 2 cm thellësi duhet të jetë më pak se 5%.

APLIKIMI

Një veshje prej Sikagard®-545 WE Elastofill duhet të aplikohet me furçë, rul ose mallë. Nëse dëshirohet një sipërfaqe me teksturë, shtresa e dytë duhet të aplikohet me rul, duke shtuar 3% ujë tek produkti. Sikagard®-550 Elastocolor ES mund të aplikohet manualisht me furçë, rul me qime të shkurtëra ose spërkatje pa ajër. Sikagard®-545 WE Elastofill duhet të vishet gjithmonë me Sikagard®-550 Elastocolor ES. Në rast se do të lyeni sërish sipërfaqet e lyera, por në gjendje të dobët, aplikuesi duhet të përcaktojë më parë aspektet e mëposhtme:

- Lloji i bojës së aplikuar

- Testim i ndërkapjes
 - Lloji i pastrimit
 - Kryeni një testim kompatibiliteti në kantier
- Nëse keni pyetje, ju lutemi kontaktoni me Departamentin Teknik.

PASTRIMI

Për materialet Sikagard®-545 WE Elastofill, Sikagard®-550 EN Elastocolor dhe Sikagard® 552 W Aquaprimer pastrimi i veglave duhet bërë me ujë.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sikagard®-545 WE Elastofill
Mars 2019, Botimi 01.01
020303030030000001

Sikagard-545WEElastofill-sq-AL-(03-2019)-1-1.pdf

